

ZYRA E KRYETARIT
KANCELARIJA PRESEĐNIKA - MAYOR'S OFFICE – BAŞKAN OFISI

Në bazë të nenit 13 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale nr. 03/L-040, nenit 78 paragrafi 1 të Statutit të Komunës së Gjilanit, me ndryshimet dhe plotësimet në Statut 01. nr. 016-28448 të datës 22.03.2018 dhe në zbatim të nenit 8 paragrafi 2 të Marrëveshjes nr.491 dt.31.05.2022, në mes të Komunës së Gjilanit dhe NPL "Tregu", Kryetari i Komunës së Gjilanit, merr këtë:


V E N D I M

1. Me këtë vendim emërohet komisioni për mbikëqyrje të zbatimit të Marrëveshjes nr.491 dt.31.05.2022, në mes të Komunës së Gjilanit dhe NPL "Tregu" për kryerjen e shërbimeve komunale në Komunën e Gjilanit, në përbërje prej tre anëtarësh:
 - 1.1.Arsim Zeqiri-Drejtoria e Arsimit
 - 1.2.Ilir Sejdiu- Drejtoria e Administratës së Përgjithshme dhe
 - 1.3.Nazif Osmani-Drejtoria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale.
2. Detyrë e komisionit është mbikëqyrja në çdo kohë e lokacioneve në të cilat kryhen shërbimet nga NPL "Tregu", performancën e shërbimeve të kryera, zbatimin e standardeve të këruara, rregullave dhe cilësinë e kërkuar me marrëveshje.
3. Komisioni për punën e tij përgatitë raport me shkrim dhe e informon Kryetarin e Komunës.
4. Ky vendim hyn në fuqi me aktin e nënshkrimit të këtij vendimi

Vendimi i dorëzohet:

- anëtarëve të komisionit
- NPL "Tregu" dhe
- arkivit

Kryetari i Komunës
Alban Hyseni





REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO 2022

L91



KOMUNA E GJILANIT
OPŠTINA GNJILANE/MUNICIPAL GJILAN/GILAN
BELEDIYESI

Bazuar në nenin 9 paragrafi 4 të Ligjit për Prokurimin Publik në Republikën e Kosovës, Nr. 04/L-042, neni 17 shkronja (f), neni 40 shkronja (j), neni 58 shkrönja (a) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale, Nr. 03/L-040, Statut n e Ndërmarrjes Publike Lokale N.P.L Sh.A. " Tregu " në Gjilan, Nr. 217/812, i plotësuar më : 04.05.2022, si dhe Statutin e Komunës së Gjilanit, neni 77 paragrafi 1 nënpargrafi 1.1, 01.Nr.16-126211 të datës 06.11.2014, me ndryshimet dhe plotësimet, 01. 016-28448 të datës 22.03.2018, me datë: 31.05.2022 lidhet :

M A R R Ë V E S H J E

PËR KRYERJEN TË SHËRBIMEVE KOMUNALE NË KOMUNËN E GJILANIT

Palët nënshkruase:

1. Komuna e Gjilanit, e përfaqësuar nga Kryetari i Komunës, z. Alban Hyseni, (në tekstin e mëtejmë Komuna, cħe)
2. Ndërmarrjes Publike Lokale "Tregu" SH.A Gjilan , i përfaqësuar nga z. Avdyl Jerliu , Kryeshef Ekzekutiv (në tekstin e mëtejmë Ndërmarrja)

Neni 1 Qëllimi i Marrëveshjes

Qëllimi i kësaj marrëveshje është :

1. Përcaktimi i shërbimeve të cilat Ndërmarrja Publike Lokale "Tregu" në Gjilan, ia ofron Komunës së Gjilanit, në bazë të standardeve të kerkura, mënyrën e ofrimit, operimit dhe menaxhimit të këtyre shërbimeve .
- 2 Ndërmarrja Publike Lokale "Tregu" dhe Komuna e Gjilanit pajtohen që t'i kryejnë obligimet e specifikuara në këtë marrëveshje si : mirëmbajtja dhe sigurimi fizik i objekteve komunale , specifikimet e shërbimeve, monitorimin e përfomancës së kryerjes së shërbimeve si cħe raportimin .

Neni 2
Kohëzgjatja e Marrëveshjes

Kjo marrëveshje vlen për periudhën tre (3) vjeqare nga momenti i konfirmimit të ligjshmërisë nga ana Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal (MAPL) me mundësi vazhdimi.

Neni 3
Shërbimet të cilat i ofron Ndërmarrja Publike Lokale 'Tregu' në Gjilan

Sipas kësaj marrëveshje, NLP "Tregu" ofron këto shërbime:

1. Mirëmbajtjen – pastrimin e objekteve të Institucioneve Publike të Komunës, si : objektet e Institucioneve Edukativo Arsimore dhe Aftësuese, objektet e Qendrës së Mjekësisë Familjare dhe objektet e Administratës Komunale që nënkupton :
 - 1.1 Kryerjen e shërbimeve të pastrimit brenda objekteve dhe hapësirave të jashtme që janë pjesë e institucionit.
 - 1.2 Pastrimi përfshinë : zyrat, inventarin, klasat, koridoret, shkallët, tualetet, mirëmbajtjen e hapësirave gjelbëruese të cilat janë pjesë e institucioneve komunale si dhe qdo shërbim tjetër të pastrimit në kuadër të fushveprimit .
 - 1.3 Pastrimi duhet të bëhet qdo ditë pune sipas orarit në përputhje me legjislacionin në fuqi. Sipas nevojës dhe kërkesave të Komunës, por edhe në rastet e veganta, pastrimi mund të bëhet edhe ditëve që nuk janë ditë pune, para apo pas orarit të punës.
 - 1.4 Në shërbimin e pastrimit duhet të angazhohen 139 punëtorë/pastrues të cilët do të sistemohen :
 - Në objektet e Institucioneve Edukativo Arsimore dhe Aftësuese, 98
 - Në objektet e Qendrën së Mjekësisë Familjare dhe DSHMS, 10
 - Në objektet e Administratës Komunale, 31
 - 1.5 Numri i shërbimeve mund të rritet sipas nevojave dhe kërkesave të Komunës.
 - 1.6 Për shërbimet e kryera të pastrimit, Komuna do të paguaj mjete financiare në vlerë prej dhe nga :
 - Buxheti i Drejtorisës së Arsimit në muaj
 - Buxheti i Drejtorisë për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale në muaj
 - Buxheti i Drejtorisë për Administratë e Përgjithshme në muaj
 2. Sigurimi fizik i objekteve publike të IEAA-ve, Qendrës së Mjekësisë Familjare dhe Administratës Komunale, që nënkupton :
 - 2.1 Sigurimin fizik të gjitha objekteve të Institucioneve Edukativo Arsimore dhe Aftësuese, objektet e Qendrës së Mjekësisë Familjare dhe DSHMS si dhe objektet e Administratës Komunale me objektet e tyre përcjellëse .
 - 2.2 Në shërbimin e sigurimit fizik duhet të angazhohen 55 punëtorë fizik/rojtarë të cilët do të sistemohen :
 - Në objektet e Institucioneve Edukativo Arsimore dhe Aftësuese, 44
 - Në objektet e Qendrën së Mjekësisë Familjare dhe DSHMS, 4
 - Në objektet e Administratës Komunale, 7
 - 2.3 Për shërbimet e kryera të sigurimit fizik, Komuna do të paguaj mjete financiare në vlerë dhe nga :

- Suxheti i Drejtorisës së Arsimit në muaj
- Suxheti i Drejtorisë për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale në muaj
- Suxheti i Drejtorisë për Administratë e Përgjithshme në muaj

Neni 4
Faturimi dhe Pagesa

1. Komuna do t'i kryej pagesat në baza mujore për shërbimet e kryera në llogarinë bankare: 170-200-101-295-4092 të NPL "Tregu".
2. Pagesa do të bëhet pas pranimit të faturës nga NPL "Tregu" dhe raportit të aprovuar të organit mbikëqyrës.
3. Dorëzimi i faturës dhe raportit të organit mbikëqyrës për punëtorët e pastrimit dhe sigurimit fizik duhet të bëhet me datën : 01 të secilit muaj pas kryerjes së shërbimit, ndërsa pagesa në llogari të kryesit të shërbimeve, do të bëhet më së largu deri me datën : 05 të secilit muaj.
4. Nëse dëta 01 ose 05 korrespondon me ditë pushimi, atëherë pagesa bëhet në ditën e parë pasuese të punës.
5. Nëse NPL "Tregu" vonon dorëzimin e faturës për shërbimin e kryer pas datës 5 të muajit pasues, atëherë pagesa e shërbimit do të shtyhet për aq ditë sa është vonuar dorëzimi i faturës.
6. NPL "Tregu" i ofron Komunës sipas nevojës një regjistër të azhurnuar të faturave që janë lëshuar dhe pagesave që janë pranuar, të ndara sipas llojeve të shërbimit.

Neni 5
Përgjegjësitë e tjera të NPL "Tregu"

1. Siguron terë personelin për të ofruar një shërbim të kënaqshëm, në mënyrë që të jetë në përputhje me specifikacionet e shërbimit që janë përfshirë në këtë marrëveshje.
2. Siguron që të gjitha faturat për shërbimet e kryera do t'i dorëzojë me kohë në Komunën e Gjilanit.
3. Siguron dhe të jetë përgjegjës për të gjitha qështjet financiare duke përfshirë pagesat e pagave me kohë për personelin e mirëmbajtjes – pastrimit dhe sigurimit fizik, të archurat dhe tatimet e tjera ose taksat e çfarëdoli jo që ndërlidhen me të punësuarit në këtë ndërmarrje apo që burojnë nga ai punësim.
4. Punëtori për punën e kryer nuk mund të mbetet (paguhet) nën pagën minimale.
5. Të janë përgjegjës për sigurinë e të gjitha pajisjeve eventuale që përdoren në lidhje me crimin e shërbimeve të përshkruara në këtë marrëveshje.
6. Të jetë përgjegjës për zbatimin e legjislacionit primarë dhe sekondarë nga marrëdhënia juridike e punës si dhe për të siguruar kushtet e nevojshme për mbrojtje në punë në përputhje me legjislacionin në fuqi.
7. Secili punëtor mban veshur rroba që janë të pastërtë për aq sa i lejojnë rrethanat, sipas nevojës edhe rroba mbrojtëse personale.
8. Punëtorët e sigurimit fizik të objekteve gjatë kohës së punës së tyre duhet të mbajnë një shenjë identifikuese (begji).
9. NPL "Tregu" sipas nevojës apo kërkesës së Komunës do të ketë autorizim me shkrim që të kontrollojë punëtorët dhe pajisjet e tyre.
10. NPL "Tregu" është përgjegjësi vetëm për pasurinë që është brenda zonës së përgjegjësisë së tij dhe hapësirë sipas kësaj marrëveshje.
11. NPL "Tregu" nuk mbanë përgjegjësi për humbjet apo dëmtimet si pasoj e ngjarjeve që paraqiten jashtë mundësisë së vet të arsyeshme për t'i kontrolluar , fatkeqësive natyrore dhe fatkeqësive të tjera të parapara me ligj .

12. Në rast se punëtori nuk e kryen detyrën e tij sipas përshtimit të detyrave të tij punuese apo bëne veprime të cilat bien ndesh me legjislacionin në fuqi, Komuna i raporton me shkrim NPL' Tregu' për ndërmarrjen e veprimeve në pajtueshmëri me aktet ligjore.

Neni 6

Obligimet tjera të NPL "Tregu"

1. Siguron numër adekuat të punëtorëve me shkathtësitë dhe trajnimin e duhur për t'i kryer shërbimet sipas kësaj marrëveshjes.
2. Në rast të paraqitjes së nevojave për shtim të numrit të punëtorëve për pastrim çhe sigurim fizik për kryerjen e shërbimeve ndaj komunës, do të bëhet pagesa shtesë e mjeteve nga buxheti i Komunës në llogari të NPL "Tregu" në baza të kritereve të njejtë të pagesave për shërbimet shtesë që do të kryhen.
3. Vlerësimin e nevojave për rritje të numrit të punëtoreve e bënë përfaqësuesi i Komunës (menaxheri/rnbikëqyerësi i kësaj marrëveshje) në koordinim me përfaqësuesin e NPL "Tregu".

Neni 7

Nënkontraktimi

NPL "Tregu" në asnjë rast nuk mund të hyj në marëdhënien nënkontraktimi me ndonjë nënkontraktor tjetër për kryerjen e shërbimeve të përcaktuara në këtë marrëveshje.

Neni 8

Përgjegjësitet e Komunës

1. Komuna do t'i kryej pagesat për shërbimet e kryera nga NPL "Tregu" në mënyrën dhe kushtet e përcaktuara sipas neni 4 të kësaj marrëveshje.
2. Komuna e cakton një komision prej tre anëtarëve për mbikëqyrje të realizimit të kësaj marrëveshje për sa i përket shërbimeve të pastrimit të objekteve publike komunale si dhe sigurimit fizik. Komisionin e përzgjedh : një Zyrtar nga Sektori i Arsimit, një nga Sektori i Shëndetësisë dhe një nga Administrata Komunale.
3. Komisioni caktohet me vendim të Krytearit të Komunës, pas marrjes së propozimeve nga ana e Drejtoreve përkatëse.
4. Komuna ka të drejt t'i inspektoj në qdo kohë lokacionet në të cilat kryhen shërbimet nga NPL "Tregu", përfomancën e shërbimeve të kryera , zbatimin e standardeve të kërkuar , rregullave dhe cilësisë së kërkuar në këtë marrëveshje.

Neni 9

Fuqia Madhore

1. Nga NPL "Tregu" nuk do të kërkohet që t'i kryej shërbimet të cilat janë saktësuar në nenin 3 të kësaj marrëveshje nesc pengohet nga ndonjë fuqi madhore.
2. Me termin 'fuqi madhore' brenda kësaj marrëveshje nënkuftojmë një ngajrje që është përtej kontrollit të arsyeshëm të një pale e cila shkakton pamundësinë e përbushjes së detyrimeve të palës në këtë marrëveshje ose është jo praktike dhe konsiderohet e pamundur për shkak të rrethanave të krijuara.
3. Fuqia madhore nuk përfshin një ngjarje e cila shkaktohet nga neglizhencë apo veprimi me qëllim i rjëres pale apo agjentëve ose punëmarrësve të saj, asnjë ngjarje të cilën një pale e kujdeshshmë në riënyrë të arsyeshme duhet të kishte marrë parasysh në kohën e nënshkrimit të kësaj marrëveshje che që mund të ishte shmangur ose tejkaluar me përbushjen e detyrimeve në këtë kontratë.

Neni 10

Zgjidhja e Mosmarrëveshjeve

Kontestet që ndërlidhen me shërbimin e ofruar dhe të paguar në kuadër të kësaj marrëveshje zgjidhen në radhë të parë gjatë takimeve operative të rregullta.

Qdo çështje që ka të bëjë me shërbimet e ofruara apo standartet e përshkruara në këtë marrëveshje dhe që mbetet e pa zgjidhur, pasi të jetë trajtuar fillimiشت duhet të shkallëzohet si vijon:

1. Niveli i parë : nëse qështja mbetet e pazgjidhur, ankesa/t duhet ti parashtrohen me shkrim bordit të drejtoreve të NPL – së, anëtarët e të cilit do ta shqyrtojnë qështjen brenda 5 ditëve të punës. Nëse çështja është e ndërlikuar dhe nuk është e mundur që të zgjidhet plotësisht brenda këtij afati kohor, atëherë një përgjigje e përkohshme me shkrim do të jepet brenda 5 ditëve të punës dhe qështja do të zgjidhet përfundimisht brenda 10 ditëve të punës.
2. Niveli i dytë : pas nivelit të parë të zgjidhjes së kontestit, nëse qështja nuk është zgjidhur ende, atëherë ankesa/t së bashku me dëshmitë përkatëse, duhet ti përcillen me shkrim komisionit komunal të akcionarëve përkatës. Ankuesit do t'i jepet një shqyrtim përfundimtar dhe një përgjigje me shkrim brenda 10 ditëve të punës.
3. Niveli i tretë : Nëse asnjë zgjidhje nuk mund të arrihet midis NPL-së dhe Komunës, qështja duhet të inicohet në Gjykatën Themelore në Gjilan. Deri të zgjidhet qështja e mosmarrëveshjes në mes të palëve, NPL "Tregu" do të vazhdojë të ofrojë shërbimet në bazë të kësaj marrëveshje.

Neni 11

Ndëshkimet në rast të Mospërmbushjes së Marrëveshjes

1. Në rast se shërbimi i kontraktuar nuk plotëson nivelin e cilësisë së parashikuar në këtë marrëveshje , atëherë Komuna do t'i zgresë 5% të faturës së shërbimit.
2. Nëse e njejtë përsëritet në muajin pasues, atëherë do të aplikohet dyfishimi i ndëshkimit që do të thotë se ndëshkimi do të jetë 10% zbritje nga pagesa e faturës së shërbimit.
3. Gjatë cilësdo fazë të zgjidhjes së paknaqësisë apo kontestit, shërbimet që ende nuk janë formuar në shkallën e dakorduar të standardit të përcaktuar në kuadër të këtij dokumenti, mund të jenë shkas për një ndëshkim finansiar që duhet të përcaktohet pas procesit të monitorimit nga Komuna.
4. Derisa të merret vendim e të qartësohet mosmarrëveshja apo pakënaqësia , NPL-ja do të vazhdoë ti ofrojë shërbimet në bazë të kësaj marrëveshje.

Neni 12

Rishikimi i Marrëveshjes

1. Kjo marrëvëshje dhe të gjitha pjeset e saj do të rishikohen sipas nevojës dhe me kërkesë të Komunës së Gjilanit ajo NPL "Tregu".
2. Për qdo nçryshim/ndërrim në shërbimet e ofruara që do të ndikoj gjatë implementimit të kësaj marrëveshje duhet të dakordohet nga dyja palët.

Neni 13

Anullimi i Marrëveshjes

1. Kjo marrëveshje mund të anulohet me pajtimin e dyja palëve me shkrim ose nëse cilado pale jep njoftim me shkrim për anulimin e marrëveshjes, dy (2) muaj para se të anulohet.
2. Nëse NPL-ja nuk i ofron shërbimet që janë përcaktuar në këtë marrëveshje gjatë një periudhe të vazhdueshme prej 3 muajsh, kjo marrëveshje do të anulohet automatikisht dhe komuna nuk do të jetë e obliguar ta paguaj asnjë faturë të dcrëzuar për shërbimet e ofruara gjatë kësaj periudhe.

Neni 14

Nënshkrimi i Marrëveshjes

Kjo marrëveshje nënshkruhet në tri (3) kopje origjinale, dy (2) për Komunën dhe një (1) për NPL "Tregu".

Neni 15

Hyrja në fuqi

Kjo marrëveshje hyr në fuqi pas nënshkrimit dhe protokolimit nga ane e dy palëve .

Datë : 31.05.2022

Nënshkruar :

Alban Hyseni


Kryetar i Komunës së Gjilanit

Avdyl Jérliu


Kryeshefi Ekzekutiv

NPL " Tregu" SH.A